



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.10.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal dhe përf, e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të shpenzimeve Janar-Shtator 2024
4. Shqyrtimi i Raportit për fermerët e vlerësuar nga Komisioni Komunal për dëmet e shkaktuara nga breshëri
5. Shqyrtimi i Raportit periodik për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit
6. Shqyrtimi i kërkesës së DPUKP-së, për Listën rezervë të emërtimit të rrugëve në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve Janar-Shtator 2024.

Enver Gashi – Fillimisht e përgëzoj Drejtorinë e financave sepse ne jemi veç në tetor dhe e kanë sjellë raportin për këtë vit, kështu që ne si grup parlamentar jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend

Sami Ahmeti – Duke qenë se është obligim i Ekzekutivit të raportoj në fazat e caktuara, ne jemi dakord dhe është e mirëseardhur që ky raport të diskutohet në seancën e ardhshme. Ndërsa, sa i përket përmbajtjes së tij vërejtjet dhe komentet tona do ti japim në seancë të Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve Janar-Shtator 2024.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Raportit për fermerët e vlerësuar nga Komisioni Komunal për dëmet e shkaktuara nga breshëri.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkoj për shqyrtim në Kuvend.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancën e Kuvendit, ndërsa sa i përket komenteve tona ato do ti japim në seancë.

Kryesuesja – Në seancë të Kuvendit do të jetë edhe drejtori i bujqësisë për çfarëdo pyetje që keni do ti merrni edhe përgjegjet.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Raportit për fermerët e vlerësuar nga Komisioni Komunal për dëmet e shkaktuara nga breshëri.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e Raportit periodik për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë të rendit të ditës jemi për atë që të debatohet në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Edhe kjo është në rregull sikurse edhe raportet tjera që të shkoj në seancë, në ndërkohë që ne jemi dakord dhe atje do ta japim kontributin tonë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit Periodik për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DPUKP-së, për Listën rezervë të emërimit të rrugëve në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Sipas rregullës dhe rendit kjo listë duhet të aprovohet në Kuvend dhe Drejtoria e ka studjue mirë, por edhe ne si anëtarë të Kuvendit nëse gjejmë ndonjë emër me plotësue e kemi atë të drejtë dhe në seancë do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Çështja e emrave të dëshmorëve dhe martirëve është çështje bukur e ndjeshme, sido që të jetë unë shpresoj që Drejtoria në fjalë i ka trajtue ashtu siç duhet, por deri atëherë do të thotë në seancë ne do të bisedojmë nëse, ka nevojë për secilin veç e veç. Ne jemi dakord që kjo të shkoj në seancë dhe të miratohet nëse, nuk ka vërejtje sepse ne nuk bëjmë dallime në mes dëshmorëve dhe martirëve, kështu që ato që kemi me i thënë do ti themi në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DPUKP-së, për Listën rezervë të emërimit të rrugëve në Komunën e Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për emërtimin e Bibliotekës së qytetit me emrin e motrave nxënëse dhe qytetare të Komunës tonë tani Dëshmore të Kombit “Shqipe e Suzana Rama”.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 7 e rendit të ditës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për emërtim të Bibliotekës së Qytetit me emrin e motrave nxënëse dhe qytetare të Komunës tonë tani Dëshmore të Kombit “Shqipe e Suzana Rama”.

Kryesuesja - Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit nr.-I-71 të dt.30.05.2014.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 8 e rendit të ditës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit nr.-I-71 të dt.30.05.2014.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit nr.-I-85, të dt.27.06.2014. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë e 9 e rendit të ditës shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit nr.-I-85, të dt.27.06.2014.

Kryesuesja – Ne sapo e kemi pranuar një kërkesë nëse, pajtoheni edhe ju që sot ta shqyrtojmë apo të mbetet për mbledhjen e radhës.

Sami Ahmeti – Varet prej rëndësisë së kërkesës, nëse kërkesa është e rëndësishme dhe nuk pret atëherë ne për këtë jemi këtu, e nëse jo e shtyejmë për mbledhjen tjetër, tash nuk e di përmbajtjen e kërkesës.

Kryesuesja – Është një kërkesë nga Vlora Mjekiqi, një nënë vetëushqyese drejtuar Komisionit për ndarje të banesave, bashkëshortja e Nasuf Mjekiqit, jeton vetëm me 3 fëmijë të mitur në shtëpinë e mixhës së burrit në fshatin Grabofc, në kushte të rënda ekonomike me pensionin e burrit 119 euro..

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan DSHPE-së, për shqyrtim kërkesën nr. -II-329-78/24 e dt.23.10.2024 nga Vlora Mjekiqi, nga fshati Grabofc.

Pika 8 e rendit të ditës

Labinot Mirena – Unë e kam një pyetje për DPUKP-në, qysh shkojnë procedurat për ndryshime të emërimit të disa rrugëve, që qytetarët më janë drejtuar mua dhe ato emërtime janë bërë shumë moti e ndoshta ata banorë nuk kanë pasë njohuri të mjaftueshme për me ndryshue emërtimin e rrugës. Mirëpo, tash janë të pajtimit me ndryshue x rrugën dhe çfarë procedura duhet të ndjekën për me ndryshue emrin e rrugës, që me emëru me një emër tjetër.

Bajram Hashani – Sa i përket emërimit të rrugëve, për 2 rrugë ne lagjen te Hashanët janë kryer të gjitha procedurat në Kuvend dhe MAPL e ka kthye, do të thotë të gjitha kanë përfunduar, po ashtu ka qe një vit kam bërë edhe pyetje te drejtorët. Unë dua të di se ku ka gëccë problemi, pse nuk po emërohen dhe tabelat kanë mbetë veç me u vendosë.

Kryesuesja – Ne do ti adresojmë pyetjet e juaja në Drejtorinë përkatëse dhe sigurisht se do ti keni përgjegjet në mbledhjen e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në ora 11:22’

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

